



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1081/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mal Lokaj kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Deçan paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Mal Lokaj kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Deçan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Mal Lokaj kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga PDK dega në Deçan në të cilën pretendon se në Qendrat e Vendvotimeve (QV), 0102C, - Dranoc; 0101X – Carrabreg; 0106C – Irzniq janë bërë keqpërdorime gjatë numërimit të votave. Në Qendrën e Vendvotimit 0102C – Dranoc djali i vëllaut të tij ka qenë vëzhgues i cili nuk është lejuar që të merr pjesë në procesin e numërimit të votave. Në Qendrën e votimit 0101X – Carrabreg kanë votuar të afërmit e tij ndërkohë që nuk ka votë (klasa e III-të. Në Qendrën e votimit 0106C – Irzniq sipas të afërmeve të tij nuk i ka votat që i janë dhënë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-i lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1081/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.